



## OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA

Tiranë, më 23.10.2024

### PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

#### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**Objekti i Procedurës: Blerje orendi dhe pajisje**

**Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV):** 39150000-8 Mobilje dhe pajisje të ndryshme.

**VLERA E FONDIT LIMIT TË KONTRATËS:** me vlerë të përgjithshme të fondit limit në vlerën **31,027,497** (tridhjetë e një milion e njëzet e shtatë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (të ndryshuar) nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Autoriteti/Enti Kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**Shtojca 7**

### **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

#### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

**Argumentimi:** Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik i ndryshuar: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prove paraprake në vend të disa

vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik”.

## **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2021, 2022, 2023) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. *(Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”, si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: .....Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.”, si dhe kërkesave të ligjit Nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës..

**2.2.2** Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e përlloritur të kontratës**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 43 pika 2/a dhe nenin 47 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri

bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet është në përputhje me përcaktimet në nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë :a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”. Në rastin konkret nga ana e Njësisë së Prokurimit është konsideruar e arsyeshme që vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë si edhe të sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë ofertuesit e mundshëm ekonomikë. Marrë shkas nga fakti që referuar përcaktimit të bërë në nenin 43 pika 2/a, AK nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së përlllogaritur të vlerës së lotit në kërkesën për kualifikim, por në respektim të parimeve ligjore dhe në përmbushjen e qëllimeve të ligjit të prokurimit si më sipër cituar ka tagrin të kërkojë një vlerë më të ulët se dyfishi i vlerës së përlllogaritur të lotit për përmbushjen e vlerës së xhiros minimale vjetore.

### 2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 40 % e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nenit 40 pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e ngjashme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikata të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

- 1) ISO 9001:2015 ose ekuivalente, “Për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë” (e vlefshme);

- 2) ISO 14001:2015 ose ekuivalente përfshirë Leje Mjedisore, “Per Sistemin e Menaxhimit te Mjedisit” (e vlefshme);
- 3) ISO 45001:2018 ose ekuivalente, “Për Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë” (e vlefshme);

**Argumentim:** Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar nëni 79 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenet 40, pika 8 dhe 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mundësitë për ekzekutimin e objektit të prokurimit si dhe vlen në vazhdimësi për realizimin e kërkesave të AK nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemeve përkatëse. Është e nevojshme që operatorët ekonomikë të jenë të çertifikuar nga organizata kombëtare/ndërkombëtare të cilat garantojnë një nivel të pranuar të menaxhimit, sa kohë që veprimtaria e tyre ka ndikim të drejtpërdrejtë mbi to. Këto standarde aplikohen për kompani të ndryshme përfshirë këtu edhe shoqëritë që ushtrojnë aktivitet tregtar, pavarësisht nëse janë prodhuese apo importuese, madhësisë apo kompleksitetit që ato kanë ose fushës së veprimtarisë që ato ushtrojnë. Gjithashtu legjislacioni i PP i jep një rendesi të posacme prokurimit te gjelber dhe pergjegjesise sociale te AK-ve dhe OE.

**3.** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar të paktën 7 (shtatë) punonjës të cilët duhet të figurojnë në listpagesën e shoqërisë të paktën muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Ky numer punonjeshish kerkohet per te vertetuar se OE ofertues ka nje numer minimal punonjeshish per te realizuar kontraten bazuar edhe ne sasine e mobiljeve qe kerkohen te levrohen, afatit te levrimit dhe vleres se fondit limit te kontrates. Punonjësit e mësipërm kërkohet që duhet të figurojnë në e-sig-et për të paktën muajin e fundit për të krijuar autoriteti kontraktor besueshmëri dhe siguri në kapacitetet që operatorët ekonomikë kanë për realizimin e kontrates objekt prokurimi.

**4.** Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar të paktën:

- 1 (një) inxhinier druri vërtetuar me:
  - a. kontratën individuale të punës;
  - b. diplomën, që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm.
- 1 (një) arkitekt vërtetuar me:
  - a. kontratën individuale të punës;
  - b. diplomën, që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm.
- 1 (një) marangoz/ mobilier/ montues mobiljesh/ përpunues druri vërtetuar me:
  - a. kontratën individuale të punës;
  - b. certifikatë, që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm;
- 1 (një) Bojaxhi për prodhime druri vërtetuar me:
  - a. kontratën individuale të punës;
  - b. certifikatë, që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm;
- 1 (një) shofer vërtetuar me:

- a. kontratën individuale të punës ose kontratë bashkëpunimi të vlefshme;
- b. leje drejtimi

- 2 (dy) punonjës për montimim, asamblimin apo transportin e mallrave vërtetuar me:

- a. kontratën individuale të punës;

**Argumentimi:** Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenit 40, pika 5/ c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ( i ndryshuar) , me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Nje inxhinier druri dhe arkitekt – artikujt jane mobilje te cilat do te prodhohen/asamblohen sipas permasave te kerkuara nga AK. Profesionistet per te realizuar porosine e prodhimit apo procesin e prodhimit ose asamblimit, montimit qe mobiljet te jene sipas specifikimeve teknike me ane te renderit apo menyrave te tjera teknike jane inxhinieri i drurit duke qene se pjesa me e madhe e mobiljeve jane me materiale druri ose imitime te tij gjithashtu duhet dhe arkitekti i cili ka njohuri per te gjithë procesin e projektimit, prodhimit, asamblimit, etj.

Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Punonjesit me specialitet e siper-permendura kerkohen ne perputhje te plote me objektin e prokurimit, me konkretisht: Marangozë dhe montator prodhime druri- pjesa me e madhe e mallrave do te prodhohen/asamblohen sipas permasave te kerkuara nga AK. Profesionistet te cilet kane eksperiencen dhe njohurine teknike per keto veprimtari jane marangozi dhe montuesi i mobiljeve. Këta punonjes kanë nje rol kyc ne zbatimin e kontrates. Punonjesit e tjere si shoferi dhe punonjesit e thjeshte jane te domosdoshem per transportin dhe punen ndihmese qe do te kryhet pergjate te gjithë proceseve te zbatimit te kontrates.

5. Të gjithë punonjësit e mësipërm duhet të figurojnë në e-sig-ët e muajit të fundit.

**Argumentimi:** Punonjësit e mësipërm kërkohet që duhet te figurojne ne e-sig-et e muajit të fundit për ti krijuar Autoritetit Kontraktor besueshmëri dhe siguri në kapacitetet që operatorët ekonomikë kanë për realizimin e kontratës objekt prokurimi.

6. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Mjete	Sasia	Gjendja
Kamionçine me kapacitet mbajtes min 3.5 ton	2 copë	Pronësi ose me qera

a) Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme) dhe certifikata e pronësisë së mjetit.

b) Për mjetet e siguruara me qera, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe certifikata e pronësisë së mjetit duhet të shoqërohet me kontraten perkatese noteriale të qerases.

**Argumentimi:** Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenit 40, pika 5/ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion mjetet e nevojshme për transportin e mallrave, për përmbushjen e kontratës

7. Operatori ekonomik duhet të ketë një ambient ku ushtron veprimtarinë sipas objektit të prokurimit, prodhim ose shitje/ tregëtim/ mobilje/ pasije zyre, për të cilën duhet të paraqesë:

- akt pronësie, kontrate qiraje apo përdorimi (i regjistruar në QKB si ambient ku ushtron aktivitetin).

**Argumentim:** *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.*

*Ky kriter vendoset në përputhje të plotë me objektin e prokurimit pasi sic kemi përmendur dhe me lart OE ofertues mund të jete jo vetëm prodhues por edhe tregëtes dhe për këtë qëllim duhet të ketë ambientin e posaçëm për zbatimin e kontratës. Objekti i këtij prokurimi është “mobilje” dhe qoftë për prodhimin apo edhe tregëtimin e tyre OE-te duhet të kenë një ambient të posaçëm për këtë veprimtari.*

8. Operatori ekonomik duhet të deklarojë se artikujt “karrige” janë sipas standardeve CE.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 dhe 79 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" të ndryshuar, nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, autoriteti kontraktor kërkon të sigurohet se, operatori ekonomik do të garantojë se malli i ofruar është cilësor dhe sipas standardeve të kërkuara në dokumentet e tenderit.*

9. Operatori Ekonomik Ofertues duhet të paraqesë një deklaratë ku merr përsipër: 1 (një) vit garanci nga momenti i furnizimit për mallrat objekt i prokurimit në momentin e dorëzimit gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin e defekteve për shkak të prodhimit dhe montimit përveç mallrave karrige të cilat duhet të kenë garanci për një periudhë prej të paktën 2 vite nga momenti i marrjes në dorëzim me përjashtim të mallrave karrige të kërkuara nga Agjencia e Inteligjencës Financiare, Ministria e Financave do të kenë garanci për 5 vite nga momenti i marrjes në dorëzim.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" të ndryshuar dhe nenin 40 pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për t'u garantuar se mallrat objekt prokurimi do të përmbushin kërkesat teknike dhe do të mbulohen të gjitha problematikat (defektet) që mund të lindin, jo për shkak të Autoritetit. Çdo prodhues ose distributor shitës ofron garanci për mallrat për një afat të caktuar. AK-ja ka kërkuar garanci me afatet e mësipërme sipas tipologjisë së mallrave e cila mbulon defekte (probleme) që vijnë nga prodhimi pas blerjes.*

10. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës deklaron se artikujt objekt prokurimi do të jenë të reja, të papërdorura më parë dhe pa dëmtime estetike apo në strukturë.

**Argumentim:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin*

e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të realizojnë objektin e prokurimit në përputhje me kërkesat e AK përfitues dhe organit qendror blerës.

**11.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë **një deklaratë**, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë **dorëzimin dhe montimin e mallrave** objekt prokurimi në adresat e përcaktuara nga Autoritetet Kontraktore përfitues.

*Argumentim:* Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se do të kryejnë transportin dhe vendosjen e tyre në gjendje të plotë përdorimi (duke përfshirë montimin, nëse është rasti), në adresën e autoritetit kontraktor.

**12.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë që produktet plotësojnë kërkesat e standardeve specifike të kërkuara në shtojcën NR. 6 në DST.

*Argumentim:* Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri operatori ekonomik ofertues garanton AK që të gjitha mallrat objekt prokurimi do të jenë sipas standardeve të kërkuara nga AK përfitues.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike:**

Specifikimet teknike janë hartuar dhe miratuar nga autoriteti kontraktor përfitues, bazuar në kërkesat për objektin e prokurimit.

Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti.

Çdo standard i kërkuar apo çdo referencë marke të mallrave objekt prokurimi autoriteti kontraktor do të pranojë edhe ekuivalentin e tij.

## **NJESIA E PROKURIMIT**